

AKT I THEMELIMIT

TE SHOQERISE “ GENERAL CONSULTING ” SH.P.K.

NENI 1.

Ortakët pjesëmarrës kanë vendosur të themelojnë një shoqëri tregtare që do të vepronte në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ligjin 129/2014, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “ Te ndryshuar si dhe me dispozitat e Statutit që i bashkëlidhet këtij Akt Themelimi të hartuar sipas këtij ligji.

Xhemaile Memo , atesia Mahmut dtl 07.07.1944 lindur në Durrës dhe banuese në Rrugë “Kodra e Diellit” , pallatet SOLUED , nr S5 , nr 17 Selite Tirane .

NENI 2.

Emri i shoqërisë është “GENERAL CONSULTING ” shpk (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar).

NENI 3.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- Organizim , Menaxhim , Konsulencë , Kontabilitet dhe administrim i shoqërive .
- Blerje dhe dhënie me qera e ndërtesave. Blerje, shitje, shkëmbim, valorizim, tregtim i tokave dhe i ndërtesave. Analizë dhe preventiva, ndërtime, ristrukturime, shkatërrime, rindërtime dhe rekuperime ndërtimore të godinave, ndërtesave civile dhe industriale, rustike. Analizë dhe preventiva, realizim, administrim dhe mirëmbajtje e veprave të vogla dhe të mëdha infrastrukturore. Analizë dhe preventiva, realizim i çdo lloji veprave dhe punë ndërtimi.
- Marrje punimesh për ndërtim, shitje, shkëmbim, ristrukturim, marrje dhe dhënie me qera, administrim dhe menaxhim pasurish të patundshme në përgjithësi, në pronësi si publike ashtu edhe private.
- Krijimi , blerja, administrimi si direkt ashtu edhe indirekt, i ndërmarrjeve që veprojnë në sektorët ekonomikë të tregtisë, industrisë dhe të shërbimeve – të tretët në përgjithësi, përfshirë aktivitetet e ndërmjetësimit dhe me përjashtim të aktiviteteve të kreditimit dhe sidoqoftë të atyre aktiviteteve për ushtrimin e të cilave kërkohen autorizime specifike përveç kur këto nuk lëshohen.
- Operacione me natyrë industriale, financiare (jo ndaj publikut) tregtare, mobiliare dhe imobiliare, përfshirë leasing (përjashtohet aktiviteti i qerasë financiare) që organi administrativ do të konsiderojë të nevojshme dhe të dobishme, edhe me ndihmën e rrjeteve telematike, si edhe të japë garanci reale dhe personale edhe në favor të të tretëve.
- Ajo mund të marrë kuota, në shoqëri të çdo lloji, në kufijtë të cilët nuk përbëjnë aktivitet mbizotërues të shoqërisë duke ju referuar ligjit dhe çdo normative tjetër në këtë fushë dhe jo ndaj publikut, për qëllimet e kolokimit dhe të aktivitetit të llojit fiduciar.

- Shoqëria mund të japë garanci, fidejusione, hipoteka dhe në përgjithësi garanci personale dhe reale, të lejojë transkriptime dhe shënime gjithshka në interes të të tretëve dhe për impenjime të të tjerëve, edhe në rast se garancia është për të gjithë ortakët ose për shoqëri me objekte të ndryshme, në të cilin një ose të gjithë ortakët janë të interesuar direkt ose indirekt, mjafton jo ndaj publikut.

NENI 4.

Qendra e shoqërisë është në qytetin e Tiranës. Ajo mund të hapë degë apo filiale për kryerjen e veprimtarisë së saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke respektuar ligjet e vendit në të cilat ato hapen.

Selia e shoqërisë është me adresë, Selite e Vogel, Kodra e Diellit, Pall. Solued S5, - Tiranë.

NENI 5.

Kapitali themeltar i shoqërisë në para është 100.000 (njëqind mijë leke), i ndarë në 1 (Një) kuotë.

Kontributi i ortakut themelues në kapitalin themeltar është:

1-Xhemaile Memo pronar i 1 (Një) kuotë, me vlerë 100.000 (njëqind mijë) leke, zoteron 100%.

Kontributet në para të derdhura janë:

- Xhemaile Memo ka derdhur 100.000 (njëqind mijë) leke dhe zoteron 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6.

Kohëzgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pa caktuar.

NENI 7.

Viti financiar, shpërndarja e fitimit të shoqërisë, administrimi, vendimet e asamblese, punësimi, kompetencat, prishja e shoqërisë para kohe, likuidimi dhe kushtet e tjera përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 8.

Akti Themelimit është përpiluar në Tiranë sot më datë 18.07.2018, autorizohet Z. Adelina Hoxha, të bëjë regjistrimin e shoqërisë pranë Q.K.B.

ORTAKU THEMELUESI

Xhemaile Memo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE EDLIRA XH HIBRAJ
Repertori Nr 709



VERTETIM

Sot ne dt 18.07.2018 perpara meje Noteres Edlira Xh Hibraj ,ne zyren time ne Bulevardi “ Barjam Curri “ Tirane u paraqiten personalisht:

Xhemaile Memo , atesia Mahmut dtl 07.07.1944 lindur ne Durres dhe banuese ne Rruga “Kodra e Diellit” , pallatet SOLUED , nr S5 , nr 17 Selite Tirane , madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtese e kartes se identitetit me nr 029094495 dhe nr personal E40707075P .

E cila ne prezencen time neneshkroi regullisht aktin e me siperm ,une Noteria vertetoj identitetin , deklarimin , firmen e sajë ne perputhje te plote me nenet e K.Civil , Ligjin “Per Noterine “

NOTERE

Edlira Xh Hibraja

[Signature]